



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:193870

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06362677

C.nr.806/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G nga fshati Gërqinë – Has, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës S, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 10,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 28.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.G nga fshati Gërqinë – Has, Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura S, me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia kompensojë në emër të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e datës 11.09.2022, shumën prej 10,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 12.09.2023 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim”.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.G nga fshati Gërqinë – Has, Komuna e Prizrenit, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij avokatit D.M nga Prizreni, më datën 12.09.2023, ka parashtruar padinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura S, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 11.09.2022, t’ia paguajë shumën prej 10.000,00 euro.

I autorizuari i paditësit avokati D.M, me parashtrësën e datës 02.10.2024 ka deklaruar se pas paraqitjes së padisë në këtë gjykatë, me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj mbi këtë bazë në mungesë të interesit juridik bëjnë heqje dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se në nenin 149.1 të LPK-së parashihet që “*në qoftë se paditësi deri në*

përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi”.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË– DEGA NË RAHOVEC-
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.806/2023, më datën 28.10.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.